



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

THIRRJE PËR APLIKIM

Në mbështetje të Ligjit 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 782, datë 26.12.2019 "Për caktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", Urdhrit të MASR nr. 88, datë 18.02.2019 "Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 41 datë 24.1.2019 "Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit", Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të UE-së, rishpall:

Thirrjen për aplikim për kandidat për anëtar përfaqësues të MASR në Bordin e Administrimit, të zgjedhur nga studentët e UE-së.

I. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe kandidaturat e paraqitura nga studentët duhet të jenë ekspertë të njohur në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike.

II. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;

- g) jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- h) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- i) është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- j) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
- k) miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
- l) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

III. Kriteret e pranimit

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos ketë marrë masën disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë;
6. Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formë së prerë.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati

1. Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike.
2. Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë.
3. Të ketë integritet etik dhe profesional.
4. Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake.
5. Të jetë i pa dënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar.
6. Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
7. Të njohë të paktën një gjuhë të huaj.
8. Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave;

IV. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit

1. Kërkesë për aplikim për anëtar i Bordit të Administrimit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.
2. Jetëshkrim i shkruar në gjuhën shqipe (CV- Kurrikulum Vitae).
3. Fotokopje e diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të autorizuara jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet vërtetimi i Njohjes dhe Njehsimit të Diplomës/Certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse.
4. Fotokopje të librezës së punës.

5. Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
6. Vërtetim ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
7. Vërtetim i lëshuar nga gjykata.
8. Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr.1/1.
9. Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2.
10. Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3.
11. Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për anëtar përfaqësues të MASR në Bordin e Administrimit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është deri më **26.02.2019**, pranë zyrës së protokoll arkivit në Rektoratin e UE-së.

V. Lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret për votim nga ana e studentëve, do të shpallet në ambientet dhe në faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” në datën 28.02.2019.

VI. Votimi për kandidatët do të zhvillohet në **datën 06.03.2019, nga ora 9⁰⁰-14⁰⁰**, në 5 (pesë) qendra të votimit, respektivisht në 5 njësi kryesore.

VII. Lista me 3 (tre) kandidaturat më të votuara do të shpallet në ambientet e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe në faqen elektronike zyrtare brenda datës 08.03.2019.

VIII. Masa e shpërblimit

Bazuar në VKM nr. 656, date 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisë të qeverisjes qendrore”, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në bordin administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE